



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 12, datë 17.05.2019

PËR

RISHIKIMIN E KUSHTEVE, NDËRTIMIN E URËS LIDHËSE DHE REHABILITIMIN E
RRUGËS EKZISTUESE PËR OBJEKTIN: “NDËRTIMI I NËNSTACIONIT TEC
KOMBINAT 110/20 KV, BASHKIA TIRANË”

Në mbështetje të Neneve 27, 28 dhe 48, të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) sh.a., Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e rishikimit të kushteve, ndërtimin e urës lidhëse dhe rehabilitimin e rrugës ekzistuese për objektin: “Ndërtimi i Nënstacionit Tec Kombinat 110/20 Kv, Bashkia Tiranë”, me zhvillues Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) sh.a.
2. Hartën e Planvendosjes bashkëlidhur këtij vendimi i bashkëlidhet Hartës së Planvendosjes së Strukturave, miratuar me vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit Nr. 5, datë 17.02.2016.
3. Dokumenti i ri i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas:
 - a) plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor;
 - b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Tiranë.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

